



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

BASHKIA BULQIZE
KESHILLI BASHKIAK

Adresa: Lagja "Minatori"

email: bashkiabulqize@hotmail.com

V E N D I M

NR 10 DATE 28 / 2 /2018

Per

"Miratimin e kerkeses se Bashkise Bulqize, se bashku me dokumentacionin ligjor per akordimin e ndihmes financiare per ujesjellesin e Qytetit te Vjeter Bulqize, i cili eshte demtuar nga reshqitja e inerteve ku kalonte tubacioni i tij, pas reshjeve te rena ne periudhen Nentor-Dhjetor 2017 nga buxheti i Bashkise dhe buxheti i vitit 2018 ne Ministrine e Puneve te Brendshme, programi "Emergjencat Civile".

BAZA LIGJORE :

Ligji 139/2015 "Per Veteqeverisjen Vendore", Ligji Nr.107, date 27.10.2016 "Per Prefektin e Qarkut", Ligji Nr 8756, date 26.03.2001 "Per Emergjencat Civile", i ndryshuar, VKM Nr. 329, date 16.05.2012 "Per kriteret dhe procedurat e dhenies se ndihmes shteterore financiare per mbulimin e demeve te shkaktuara nga fatkeqesi natyrore ose fatkeqesi te tjera te shkaktuara nga veprimtaria njerezore", **Keshilli bashkiak ne mledhjen e tij te dates 28.02.2018 pasi analizoi dhe diskutoi rreth projekt vendimit te paraqitur nga Drejtorie e Sherbimeve, Emergjencave Civile dhe Rrugeve Rurale me 15 vota pro, asnje kunder dhe asnje abstenim**

V E N D O S I :

1. Te miratoje kerkesen e Bashkise Bulqize per mbeshtetje financiare per ujesjellesin e Qytetit te Vjeter Bulqize per demtimin e tij nga reshqitja e inerteve pas reshjeve te rena.
2. Te miratoje dokumentacionin tekniko-ligjor te hartuar nga Bashkia Bulqize, dhe vleren e demit teshkaktuar 5.783.053 (pese million e shtateqind e tetedhjetë e tremije e pesedhjetë e tre) leke deme.
3. Ti paraqese dokumentacionin perkates dhe ti kerkoje mbeshtetje Drejtorise se Pergjitheshme te Emergjencave Civile prane Ministrise se Puneve te Brendshme per akordimin e ndihmes financiare, per shkak te pamundesise se Bashkise per te mbuluar kerkesat financiare per riparimin e defektit me buxhetin e saj.
4. Ndhima financiare per ujesjellesin percaktohet sipas kritereteve VKM nr.329, date 16.05.2012.

5.Ndihma financiare qe do te akordohet do te perdoret per riparimin e defektit ne Ujesjellesin e Qytetit te Vjeter Bulqize.

Ky vendim hyn ne fuqi pas konfirmimit nga Prefekti i Qarkut Diber.

PER KESHILLIN BASHKIAK

SEKRETARI

Agim TUCI



KRYETARI

Gazmend KENGA



Dixhitalizuar ne kuader te projektit STAR II permes Qendres per Cheshtje e Informimit Publik
www.infocip.org
www.vendime.al